VENDIM
Nr. 848, datë 27.9.2013

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 655, DATË 7.8.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR HEQJEN NGA FONDI KULLOSOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E EKONOMISË KULLOSORE "MALI I RRENCIT-KAKARRIQ" LEZHË, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA "COLACEM ALBANIA" SHPK PËR SHFRYTËZIMIN E GURIT GËLQEROR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 2.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 655, datë 7.8.2013 të Këshillit të Ministrave "Për heqjen nga fondi kullosor të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë kullosore "Mali i Rrencit-Kakarriq", Lezhë, që do të përdoret nga shoqëria "Colacem Albania" sh.p.k., për shfrytëzimin e gurit gëlqeror".
2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama